



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 1597/23

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 29.12.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN

REPubLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



**PLANI I PUNËS
SË KRYETARIT TË KOMUNËS – QEVERISË KOMUNALE PËR VITIN 2024**

Dhjetor, 2023

Hyrje

Kryetari i komunës i ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e tij bazuar në dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, ligjeve dhe akteve nënligjore, që janë me interes për komunën dhe qytetarët. Këto kompetenca dhe përgjegjësi realizohen po ashtu edhe në bazë të planit të tij të punës, i cili është dokument bazë për punën njëvjeçare të kryetarit të komunës, përkatësisht qeverisë komunale.

Në Planin e punës së Kryetarit të komunës përkatësisht qeverisë komunale janë paraqitur prioritetet, objektivat, aktivitetet e planifikuara, si dhe afatet për realizimin e tyre. Ky plan natyrisht që gjatë vitit 2024 do të mund të plotësohet varësisht prej nevojave dhe mundësive buxhetore.

Përmes këtij plani ne do të mund të kanalizojmë nismat për planifikim të objektivave, përkatësisht prioritetëve, të cilat do të mund të realizohen bazuar në planifikimin buxhetor të vitit 2024 për realizim të projekteve kapitale të cilat i kemi planifikuar në këtë vit për t'i realizuar në vitin që po hyjmë për të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët tanë. Gjatë përmbushjes së këtyre objektivave sigurisht që ka sfida, por me një angazhim të përbashkët të Qeverisë komunale dhe të Kuvendit mund të arrihen rezultate të dëshirueshme.

Prioritetet kryesore gjatë vitit 2024:

- Menaxhimi efektiv dhe transparent i buxhetit të komunës;
- Angazhimet e vazhdueshme për realizimin e të hyrave të planifikuara buxhetore dhe shfrytëzimi sa më racional i mjeteve buxhetore, përkatësisht shpenzimeve buxhetore, si dhe raportimi i rregullt në Kuvendin e Komunës;
- Implementimi sipas planifikimit i projekteve kapitale, si dhe angazhimi për shpenzim maksimal të mjeteve financiare të investimeve kapitale, sidomos mjeteve të grantit qeveritar;
- Ndërmarrja e masave për furnizim me ujë të pijes në të gjitha vendbanimet e komunës ku është i shtrirë rrjeti primar dhe sekondar;
- Rregullimi i shtratit të lumit Tërstena, Podrança, vazhdimi i punimeve në rregullimin e shtratit të lumit “Podrança”, Studime dhe Smrekonicë;
- Ndërtimi i kolektorit kryesor në Sfaraçak si dhe atij Nedakoc-Studime, Pasomë, Bajskë, Sllatinë si dhe kanalizimeve në fshatra, (vazhdim nga v. 2023);
- Ndërtimi i urave dhe mureve mbrojtëse aty ku do të jetë e nevojshme;
- Ndërtimi i stacionit të pompimit në pjesën lindore të komunës;
- Shfrytëzimi sa më racional i pronave (tokave dhe objekteve) në pronësi të komunës përmes dhënies në shfrytëzim;
- Mbikëqyrja e implementimit të kontratave për pronat e komunës që janë dhënë në shfrytëzim qoftë afatshkurtër apo edhe ato afatgjatë (tokave dhe objekteve);
- Ndërmarrja e masave për lirimin e pronave komunale të uzurpuara;
- Angazhimet për gjetjen e donatorëve për investime kapitale në komunë e në veçanti në sektorin e bujqësisë;
- Rritja e prodhimit të bujqësore, përmirësimi i cilësisë së atyre prodhimeve, organizimi i trajnimeve dhe këshillimeve profesionale për fermerë, si dhe subvencionimi i tyre;

- Subvencionimet e bujqve;
- Angazhimet për investime nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor për ndërtimin e argjaturave buzë lumit “Silnica” për mbrojtje të tokave bujqësore nga vërshimet, të cilat janë duke shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale në bujqësi;
- Angazhimet për kthimin në pronësi të komunës të parcelave që më herët iu ishin dhënë në shfrytëzim Burgut të Smrekonicës, të cilat tani evidentohen në emër të Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim të themelimit të zonës së lirë ekonomike në fsh.Banjskë dhe Smrekonicë;
- Menaxhim më i mirë i mbeturinave, duke marrë për bazë Planin për menaxhimin e mbeturinave;
- Ofrimi i shërbimeve administrative sa më cilësorë ndaj qytetarëve;
- Gjithëpërfshirja në arsim dhe ngritja e cilësisë së punës në institucionet e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore;
- Avancimi i aktiviteteve kulturore atyre të rinisë dhe në lëmin e sportit;
- Ofrimi i mbështetjes së klubeve sportive, organizatave të dala nga lufta, organizatave rinore, OJQ –ve tjera të komunës, si dhe kategorive tjera;
- Bashkëpunimi me organet e nivelit qendror, veçanërisht me qeverinë dhe ministrinë e linjës në aspektin e zbatimit të ligjshmërisë, në rastin e marrjes së vendimeve me rëndësi dhe interes për komunën dhe qytetarët;
- Bashkëpunimi me organizatat vendore e ndërkombëtare;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe qytetarë, duke krijuar mundësitë për pjesëmarrje sa më të madhe të tyre në proceset e vendimmarrjes në komunë;
- Mbështetja e Ndërmarrjes Publike Komunale “Përparimi”;
- Funkcionalizimi i Qendrës për qëndrim ditor për të moshuarit;
- Ndërtimi i shesheve dhe parqeve në hapësira publike;
- Zgjerimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik;
- Rregullimi i memorialëve;
- Zgjerimi i rrjeteve të vendosjes së kamerave në qytet dhe shkolla;
- Angazhime tjera për çështje me rëndësi dhe interes për qytetarët për mirëqenie dhe jetë më të mirë të tyre.

Planifikimet sipas drejtorive

Buxheti dhe Financat

Nr.	Drejtoria	Objektivat	Aktivitetet	Afati	Ecuri	Pjesëmarrësit tjerë	Ndërlidhjet me
1	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	1. Hapja e viti fiskal dhe përgatitjet për startimin e sistemit të pagesave (Free Balanc) për vitin fiskal 2024.	1. Kompletimi i dokumentacionit për të gjitha programet buxhetore dhe monitorimi i tyre	1. Janar/2024		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

2	2. Rregullimin e dokumentacionit për personat me autorizimet e veçanta personat: nëpunësi administrativ i pagesave, personi autorizues, personi aprovues, personi zotues dhe certifikuesi për periudhën 2024.	2. Plotësimi i kërkesës për qasje të përdoruesve në SIMFK.	2. Janar/2024	Sipas planit të rrjedhës së parasë së gatshme		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
3	3. Pasqyrat financiare për buxhetit për vitin 2023	3. Plotësimi më efikas dhe dorëzimi i PVF	3. Janar/2024			
4	4. Përgatitja e rrjedhës së parasë për të gjitha programet për vitin 2024	4. Plotësimi i formularëve të rrjedhës së parasë në bazë të planifikimit të buxhetit në MEF.	4. Janar/2024			
5	5. Bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2023	5. Implementimi i të hyrave të bartura në vitin 2022	5. Shkurt-Mars/2024			
6	6. Përgatitja e Raporteve tremujore për vitin 2024	6. Implementimi i raporteve në Kuvend dhe Ministri	6. Çdo tre muaj			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
7	7. Përgatitjet e duhura për realizimin e projekteve të pa kryera nga viti 2023 (projektet investuese).	7. Kompletimi i dokumentacionit për zotimin e mjeteve	7. Shkurt-Mars/2024			
8	8. Barazimi mujor i shpenzimeve në sistemin FB	8. Përmbajtja e afatit kohor në bazë të Udhëzimit administrativ 02/2010	8. Çdo muaj/2024			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

9	9. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave vetanake për tremujorin e parë.	9. Përgatitja e informatës lidhur me realizimin e buxhetit dhe inkasimin e të hyrave për të gjitha programet buxhetor	9. Çdo tre muaj/2024			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
10	10. Prezantimi i Qarkores 01/2024 kufijve të par buxhetor dhe përpunimi i buxhetit për vitin 2024 konform qarkoreve të marra nga MEF-i	10. Të harmonizoj kërkesat e drejtorive për ndryshimin eventual të buxhetit të rishikuar për vitin fiskal 2023	10. Maj-Qershor/2024			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
11	11. Të harmonizoj kërkesat e drejtorive për ndryshimin eventual të buxhetit të rishikuar për vitin fiskal 2024	11. Të harmonizoj kërkesat e drejtorive për ndryshimin eventual të buxhetit të rishikuar për vitin fiskal 2024	11. Qershor/2024			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
12	12. Përgatitjet për rishikimin buxhetor (varësisht nga kërkesat e MEF-it)	12. Përgatitja e formularëve lidhur ndryshimet buxhetore	12. Qershor-Korrik/2024			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
13	13. Përcjellja e realizimit të shpenzimeve buxhetore të mjeteve sipas dinamikës së paraparë për gjashtëmujorin e parë për vitin fiskal 2024	13. Raportimi informatës lidhur me projektet e realizuara në bazë të planifikimit të buxhetit	13. Qershor/2024			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
14	14. Informatë për realizimin e investimeve kapitale, realizimi i projekteve të parapara me planin dinamik të shpenzimeve.	14. Përgatitja e informatës lidhur me shpenzimet buxhetore	14. Korrik/2024			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

15	16. Përgatitja e tregueseve final buxhetor për vitin 2025 konform qarkores nga MEF-i	16. Evidentimi i të gjitha kërkesave të drejtorive për vitin fiskal 2025.	16. Shtator/2024			Të gjitha programe buxhetore të drejtorive
16	17. Përgatitjet për përmbylljen e vitit fiskal buxhetor 2024		17. Dhjetor/2024			Të gjitha programe buxhetore të drejtorive

Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim rural

Nr.	Prioritetet	Aktivitetet e planifikuara	Koha e implementimit	Buxheti €	Akterët implementues të projektit
1	Hartimi i planeve dhe raporteve për drejtorinë e EBPZHR	Hartimi i planit të punës për vitin 2024. Hartimi i raportit të punës për vitin 2023	dhjetor2023 janar 2024	-	Drejtoria e EBPZHR
2	Regjistrimi i bizneseve në kuadër të ARBK- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	Shqyrtimi i kërkesave për aplikim për regjistrim të bizneseve, procedimi në Ministrinë gjegjëse, shpërndarja e Certifikatave. Shqyrtimi i kërkesave për ndryshime në Certifikatë të biznesit, procedimi i lëndës në Ministrinë gjegjëse, njoftimi i palës për ndryshime dhe aprovime. Shqyrtimi i kërkesave për shuarje të biznesit, procedimi i lëndës në Ministrinë gjegjëse, njoftimi i palës për miratim. Vërtetime sipas nevojave të palëve.	Janar-dhjetor		QKB
3	Hartimi i propozim vendimeve, shqyrtimi dhe përgjigjja në kërkesa, hartimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit etj.	Hartimi i të gjithave akteve dhe vendimeve në kohë të duhur. Shqyrtimi dhe përgjigjja e të gjitha kërkesave në afat brenda kornizave ligjore. Përfaqësimi në institucione shtetërore	Janar-dhjetor	-	Kryetari i Komunës, Drejtoria e EBPZHR
4	Përgatitja e	Hartimi i propozim projekteve-paramasave,	Janar-	-	Drejtoria e

	projekteve-paramasave.	shpalljeve me të gjitha aktet përcjellëse	tetor		EBPZHR
5	Shërbime për fermerë	Regjistrimi dhe ndryshimet eventuale të fermerëve në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të fermave në EFR. Aplikimi i fermerëve për subvencione të shpallura nga MBPZHR, digjitalizimi me ELPIS, pranimi i dokumentacionit, dorëzimi në AZHB. Angazhimi në Programin e Shërbimeve Këshillimore të MBPZHR për fermerë. Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve për fermerë.	Janar-dhjetor	-	Drejtoria e EBPZHR
6	Ngritja e komisioneve, hartimi i raporteve për nevoja të Komunës dhe MBPZHR	Planifikimi i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore-raportimi. Formimi i komisionit për procesin e korrjes së drithërave, përcjellja e procesit – raportimi.	Janar - dhjetor	-	Kryetari i Komunës, Drejtoria e EBPZHR
7	Bashkëpunimi me OJQ dhe akterë tjerë	Vazhdimi i bashkëpunimit me OJQ me të cilat jemi duke bashkëpunua si dhe angazhimi i lidhjeve dhe bashkëpunimit me OJQ vendore dhe ndërkombëtare	Janar-dhjetor	-	Kryetari i Komunës, Drejtoria e EBPZHR

PJESA FINANCIARE E PROJEKTEVE TË PLANIFIKUARA

Lloji i investimit	Vlera e planifikuar
Renovimi dhe fasadimi i objekteve banesore	1,500.000.000
Ndërtimi i objekti për nevoja të Kryqit të Kuq-projekt me bashkëfinancim	20,999.63
Rregullimi dhe pastrimi i lumit Llap-Silnica-Projekt me bashkëfinancim	698,635.70
Iber-Lepenc pagesa 50% e ujitjes	45,000.00
Subvencionimi i Qumështit	160,000.00
Subvencionimi i Deleve, Dhive dhe Buallicave	20,000.00
Subvencionimi i Bletëve	40,000.00
Ndërtimi i rrugës Pestovë-Druar-Projekt me bashkëfinancim	267,904.07
Ndërtimi i tregut të gjelbër Projekt me bashkëfinancim IRW	230,000.00
Ndërtimi i serrave 100 m ² Projekt me IRW (Obligim)	75,000.00
Projekte për fermer/e me IADK	20.000.00
Gjithsej	1,577,539.40

Administrata

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Administratës është e organizuar në këta sektorë:

1. Zyra e Gjendjes civile;
2. Sektori për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informative;
3. Qendra për Shërbim me Qytetar.
4. Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore

Objektiv i përgjithshëm strategjik:						
Funksionalizimi dhe digjitalizimi i arkivit komunal						
Vendosja e shenjave unike të klasifikimit të dokumenteve sipas afateve të ruajtjes dhe dorëzimi i të gjitha dosjeve dhe dokumenteve në mënyrë të drejtë dhe sipas akteve ligjore dhe nënligjore në arkivin komunal.						
Shërbime administrative kualitative, të qasshme, të bazuara në procedura administrative të arsyeshme dhe duke përdorur metodat e e-qeverisjes të orientuara kah nevojat e qytetarëve dhe bizneseve.						
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Përgjegjës	Mbështetës	Kostoja totale	Burimi i financimit	Produkti
Funksionalizimi i Arkivit të Komunës	Gjatë tërë vitit	Drejtorja për Administratë	Të gjitha Drejtoritë			Arkiv funksional
Funksionalizimi i depos së komunës	Gjatë tërë vitit	Drejtorja për Administratë				Depo funksionale
Hartimi i udhëzuesit me informacione në lidhje me procedurat dhe shërbimet që ofrohen nga komuna	Qershor 2024	Drejtoritë & QSHQ	Kryetari i komunës			Udhëzuesi i miratuar
Furnizim me TI dhe pajisje të tjera	15 Maj 2024	Drejtorja për Administratë & Drejtoria për Prokurim		20,000.00	Komuna	Pajisje të TI
Trajnimi i vazhdueshëm i Nëpunësve Civil.	Gjatë tërë vitit	Zyra e personelit në bashkëpunim me IKAP				Nëpunësit civil

		dhe Drejtoritë				
Mirëmbajtja e objektit	Gjatë tërë vitit	Drejtoria për Administratë		20 000.00	Komuna	Kontratë e nënshkruar për mirëmbajtjen e objektit
Mirëmbajtja e sistemit të klimatizimit dhe ngrohjes	Gjatë tërë vitit	Drejtoria për Administratë		3500.00	Komuna	Sistemi i klimatizimit funksional
Mirëmbajtja e gjeneratorit te objektit të komunës	Gjatë tërë vitit	Drejtoria për Administratë		1500.00	Komuna	Gjenerator funksional
Mirëmbajtja e ashensorit	Gjatë tërë vitit	Drejtoria për Administratë		1200.00€	Komuna	Ashensor funksional
Mirëmbajtja e e-kioskut	Gjatë tërë vitit	Drejtoria për Administratë		2500.00	Komuna	Kontratë e nënshkruar për mirëmbajtjen e e-kioskut
Servisimi dhe mirëmbajtja e aparateve kundër zjarrit	Dy here brenda vitit	Drejtoria për Administratë		2000.00	Komuna	Kontratë e nënshkruar për mirëmbajtjen e aparateve
Mirëmbajtja e sistemit të radhës së pritjes	Gjatë tërë vitit	Drejtoria për Administratë		5000.00	Komuna	Kontratë e nënshkruar për mirëmbajtjen e sistemit
Lidhja e akteve në formë të libërlidhjes	Janar 2024	Drejtoria për Administratë		1000.00 €	Komuna	Kontratë e nënshkruar për libërlidhjen e akteve
DDD në objektin e komunës	Tetor 2024	Drejtoria për Administratë		1000.00	Komuna	Kontratë e nënshkruar për DDD
Punimi dhe vendosja e shenjzimeve në objektin e komunës	Mars 2024	Drejtoria për Administratë		3000.00	Komuna	Shenjzimi i tere objektit

Rregullimi i sporteleve për QSHQ-në/ndarje fizike	Shkurt 2024	Drejtoria për Administratë		20 000.00	Komuna	Zgjerimi i sporteleve për shërbim
Zërimi elektronik për sallën e Kuvendit	Shkurt 2024	Drejtoria për Administratë		30 000.00	Komuna	Zërimi funksional
Rregullimi i sallës së re	Shkurt 2024	Drejtoria për Administratë		12 000.00	Komuna	

Zyra e Gjendje Civile

Qëllimi kryesor (Objektivat)	Aktiviteti (Detyrat)	Afatet	Bartësit
1. Përditësimi i shënimeve dhe të dhënave personale të qytetarëve në mënyrë të drejtë dhe sipas akteve ligjore dhe nënligjore në Regjistrin qendror elektronik të gjendjes civile dhe administrimi i regjistrave themeltar fizik.	<p>1.1. Verifikimi i qytetarëve në regjistrin themeltar elektronik dhe unifikimi i të dhënave dhe shënimeve me regjistrin themeltar fizik dhe elektronik.</p> <p>1.2. Mirëmbajtja dhe kujdesi i regjistrave themeltar fizik dhe elektronik dhe të dokumenteve të arkivuara.</p> <p>1.3. Përditësimi i shënimeve dhe regjistrimi i shtetasve në regjistrin themeltar dhe regjistrin qendror elektronik.</p> <p>1.4. Regjistrimi i shtetasve sipas nenit 31 dhe 32 të ligjit për gjendjen civile.</p> <p>1.5. Përditësimi dhe regjistrimi në regjistrin themeltar dhe qendror të vendbanimit dhe vendqëndrimit,</p> <p>1.6. Riregjistrimi (Rikonstruksioni) i personave që dëshmojnë që kanë qenë të regjistruar më parë në regjistrin themeltarë.</p> <p>1.7. Regjistrimi i shtetasve të huaj në regjistrin qendror,</p> <p>1.8. Regjistrimi i personave të natyralizuar sipas vendimit të MPB-së,</p> <p>1.9. Përdorimi dhe shfrytëzimi i aplikacionit të GJC sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë fushë,</p>	Sipas afateve ligjore	Zyrtarët e Gjendjes civile
2. Shqyrtimi i kërkesave dhe nxjerrja e vendimeve në mënyrë të drejtë dhe sipas akteve ligjore dhe nënligjore për korrigjimin, ndërrimin dhe regjistrimin me vonesë të fakteve të lindjes dhe fakteve të vdekjes.	<p>2.1. Nxjerrja e vendimeve për korrigjime të të dhënave personale,</p> <p>2.2. Nxjerrja e vendimeve për ndërrim të emrit personal,</p> <p>2.3. Nxjerrja e vendimeve për regjistrim me vonesë të faktit të lindjes dhe vdekjes,</p> <p>2.4. Nxjerrja e vendimeve për anulimin e regjistrimeve të faktit të lindjes,</p> <p>2.5. Nxjerrja e vendimeve për korrigjimin e akteve të lindjes, martesës dhe vdekjes,</p> <p>2.6. Nxjerrja e vendimeve për korrigjimin e librit fizik të lindjes, martesës dhe vdekjes,</p>	Sipas afateve ligjore.	Zyrtarët e Gjendjes civile

<p>3. Regjistrimi i fakteve të lindurve dhe të të vdekurve në regjistrat themeltar në mënyrë të drejtë dhe sipas akteve ligjore dhe nënligjore, shtypja dhe mbajtja e akteve në mënyrë korrekte dhe cilësore duke krijuar dosje për së cilën rast dhe digjitalizimi i të gjitha dosjeve.</p>	<p>3.1. Pala duhet të informohet shpejtë, saktë, me shkrim dhe me gojë, 3.2. Regjistrimi i fakteve të lindjeve, martesave dhe vdekjeve në regjistrin themeltar dhe në regjistrin Qendror elektronik të gjendjes civile, 3.3. Të gjitha aktet duhet të shtypen dhe të pasqyrojnë shënimet e sakta, të nënshkruhen nga zyrtari, pala dhe të vulosen, 3.4. Regjistrimet e mëvonshme në bazë të vendimeve, 3.5. Regjistrimet e veçanta(speciale),faktet që ndodhin jashtë vendi, 3.6. Regjistrimi i fëmijëve të adoptuar në bazë të vendimit të gjykatës, 3.7. Të regjistrohen të gjithë personat e natyralizuar sipas vendimit të DSHAM-së, 3.8. Të krijohen aktet dhe të arkivohen dhe në fund të vitit të lidhen libër, 3.9. Gjenerimi dhe lëshimi i numrin personal,</p>	<p>Sipas afateve ligjore.</p>	<p>Zyrtarët e Gjendjes Civile</p>
<p>4. Regjistrimi i martesave në mënyrë të drejtë dhe sipas akteve ligjore dhe nënligjore, brenda orarit të punës dhe regjistrimi i martesave jashtë selisë së komunës dhe jashtë orarit të punës, duke i shtypur dhe mbajtur aktet në mënyrë korrekte, cilësore dhe duke krijuar dosje për së cilën rast dhe digjitalizimi i të gjitha dosjeve te martesave.</p>	<p>4.1. Identifikimi i palës përmes një dokumenti të identifikimit, 4.2. Informimi i palëve për kushtet dhe procedurat e kurorëzimit, 4.3. Caktimi i terminëve për lidhjen e martesës, 4.4. Shpallje e martesave, 4.5. Sigurimi i ambient solemn dhe komod për çiftet me rastin e martesës, 4.6. Regjistrimi i shtetaseve të huaj në regjistrin qendror me rastin e paraqitjes së kërkesës për kurorëzim, 4.7. Të gjitha aktet shtypen dhe pasqyrojnë shënimet e sakta, pastaj nënshkruhen nga zyrtari dhe çifti dhe vulosen, 4.8. Aktet arkivohen në dosje sipas lëndës dhe digjitalizohen, 4.7. Lidhja e martesave jashtë selisë së komunës, 4.9. Lidhja e martesave jashtë orarit të punës në selinë e komunës,</p>	<p>Sipas afateve ligjore.</p>	<p>Zyrtarët e Gjendjes Civile</p>
<p>5. Lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve të tjera të Gjendjes Civile, në mënyrë të drejtë dhe sipas akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe dhënia e shërbimeve të tjera në mënyrë efektive dhe pa gabime.</p>	<p>5.1. Identifikimi i palës përmes një dokumenti të identifikimit, 5.2. Informimi i shpejtë dhe i saktë, me shkrim dhe verbal, 5.3. Lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve në mënyrë efektive, 5.4. Komunikimi korrekt i zyrtarit me palë duke respektuar kodin e etikës, 5.5. Inkasimi i drejtë i pagesave për shërbimin e dhënë, printimi dhe nënshkrimi i fletëpagesës nga pala dhe zyrtari, 5.6. Certifikatat dhe dokumentet i jepen vetëm personit që i përkasin, përveç rasteve me prokurë, 5.7. Respektimi i orarit të punës, 5.8. Zbatimi i vendimeve për ndryshimin dhe korrigjimin e të dhënave personale në regjistrin qendror elektronik,</p>	<p>Sipas afateve ligjore.</p>	<p>Zyrtarët e Gjendjes Civile</p>

	<p>5.9. Përcjellja e vendimeve për ndryshime dhe korigjime të të dhënave personale në regjistrin themeltar fizik,</p> <p>5.10. Zbatimi i Aktgjykimeve të gjykatës për shkurorëzim,</p> <p>5.11. Zbatimi i vendimeve për regjistrimin e mëvonshëm të fakteve të lindjes dhe vdekjes,</p> <p>5.12. Zbatimi i raportit policor për dokumentet e humbura,</p> <p>5.13. Zbatimi i deklaratës për kthimin e mbiemrit të lindjes pas shkurorëzimit,</p> <p>5.14. Zbatimi i deklaratës së Atësisë-Amësisë</p> <p>5.15. Zbatimi i vendimit të gjykatës mbi themelimin e adoptimit</p> <p>5.16. Kompletimi i dosjes për fitim dhe humbje të shtetësisë,</p> <p>5.17. Kërkesa për natyralizim(fitim) parashtrohet personalisht,</p> <p>5.18. Kërkesa për humbje me lirim të shtetësisë bëhet personalisht,</p> <p>5.19. Pala duhet të trajtohet nga zyrtari deri në fund duke qenë i kujdesshëm,</p> <p>5.20. Çdo certifikatë e dëmtuar duhet të raportohet dhe të anulohet në sistem,</p> <p>5.21. Ruajtja e regjistrave dhe dosjeve me të DHP në orman metalik ku siguria e tyre është e garantuar.</p>		
6. Azhurnimi i të gjitha kërkesave në intranet duke ju dhënë përgjigje dhe zgjidhje në mënyrë efektive dhe pa gabime.	<p>6.1. Komunikimi dhe sqarimi i palës në lidhje me procedurat duhet të jetë prioritet i zyrtarit,</p> <p>6.2. Ofrimi i shërbimeve duhet të jetë i shpejtë dhe sa më efikas,</p> <p>6.3. Aftësimi dhe njohja sa më e mirë e kompjuterit dhe aplikacionit të gjendjes civile dhe intranetit,</p> <p>6.4. Informimi dhe përgjigje në kërkesat e palëve përmes internetit,</p> <p>6.5. Komunikimi përdorimi i email-it zyrtar,</p> <p>6.6. Krijimi i dosjes për çdo kërkesë (kërkesa, fletëpagesa dhe ID),</p> <p>6.7. Çdo kërkesë duhet të marr përgjigje brenda ditës në Intranet,</p> <p>6.8. Raportimi, ditor, javor dhe mujor,</p>	Sipas afateve ligjore.	Udhëheqësi i Zyrës së Gjendjes Civile dhe Zyrtarët e Gjendjes civile
7. Ruajtja e fshehtësisë së të dhënave personale në mënyrë të drejtë dhe sipas akteve ligjore dhe nënligjore dhe komunikimi i tyre vetëm personave që i parashih ligji.	<p>7.1. Të dhënat personale i komunikohen vetëm personit për të cilën mbahen shënimet,</p> <p>7.2. Certifikatat dhe dokumentet i jepen vetëm personit që i përkasin,</p> <p>7.3. Ruajtja e regjistrave dhe dosjeve me të DHP në orman metalik ku siguria e tyre është e garantuar.</p>		Zyrtarët e Gjendjes Civile
8. Vendosja e shenjave unike klasifikuese të dokumenteve, afatet e ruajtjes dhe dorëzimi i të gjitha dosjeve dhe dokumenteve në	<p>8.1. Vendosja e shenjave unike klasifikuese të dokumenteve,</p> <p>8.2. Klasifikimi sipas afateve ligjore për ruajtje,</p> <p>8.3. Rendita dhe sistemimi i dokumenteve ne regjistrator fizik për ruajtje,</p> <p>8.4. Regjistrimi dhe hartimi i procesverbalit për pranim-</p>	Sipas afateve ligjore	Udhëheqësi i Zyrës së Gjendjes Civile dhe Zyrtarët e Gjendjes

mënyrë të drejtë dhe sipas akteve ligjore dhe nënligjore në arkivin komunal	dorëzim në arkivin komunal		civile
9. Organizimi i trajnimeve për të gjithë zyrtarët e gjendjes civile	9.1. Trajnimi për zbatimin e drejtë të akteve ligjore dhe nënligjore, 9.2. Trajnimi për respektimin e kodit të etikës dhe menaxhimin e palëve të revoltuara, 9.3. Trajnimi për fuqizimin e aktivizimin social, përmirësimin e shkathtësive sociale të cilat do të ndikojnë në ruajtjen e marrëdhënieve për të punuar me të tjerët dhe krijimin e një ambienti më të përshtatshëm për punë, 9.4. Trajnimi për zbatimin e sistemeve elektronike (Intranet, arkivit elektronik dhe digjitalizimit)	Mars-Prill Prill-Maj Maj-Qershor	Udhëheqësi i Zyrës së Gjendjes Civile dhe Zyrtarët e Gjendjes civile

Sektorit për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informativë

Objektivat	Aktiviteti (Detyrat)	Afatet	Bartësit	Vërejtje
1. Funkcionaliteti i tërë sistemit të teknologjisë informative të administratës së komunës	1.1 Implementimi i të gjitha politikave dhe procedurave të TI; 1.2 Kujdesi për zbatimin e politikës së sigurisë së rrjetit, shfrytëzimit të resurseve të TI; 1.3 Jap propozime lidhur me buxhetin vjetor lidhur me investimet dhe mirëmbajtjen e TI;	Gjatë tërë vitit	Udhëheqësi i sektorit	
2. Administrimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë për të siguruar qasje maksimale	2.1 Administrimi i serverëve dhe pajisjeve tjera qendrore të sistemit të TI në Komunë; 2.2. Mirëmbajtja, instalimi, konfigurimi, testimi dhe zgjerimi i rrjetit; 2.3 Formatizime, instalime të aplikacioneve apo softuerëve të ndryshme si dhe zgjidhja e problemeve të ndryshme softuerike; 2.4 Administrimi dhe mirëmbajtja e ueb faqes zyrtare, aplikacioneve dhe bazave të të dhënave të komunës; 2.5 Evitimi i defekteve dhe rekomandimi për servisim të pajisjeve të TI;	Gjatë tërë vitit	Udhëheqësi i sektorit; Zyrtari i TI	
3. Mbështetje lidhur me përdorim dhe shfrytëzim të resurseve të TI	3.1 Trajnon dhe aftëson stafin për përdorim të teknologjisë ekzistuese dhe teknologjive të reja; 3.2 Ofrimi i qasjes për gjithë personalin në sistemin e TI dhe resurset e saja;	Gjatë tërë vitit	Udhëheqësi i sektorit; Zyrtari i TI	
4. Menaxhimi dhe administrimi i punëve të përbashkëta	4.1 Identifikimi i nevojave për drejtorinë për furnizim me pajisje, dhe mirëmbajtjen e tyre; 4.2 Mbikëqyrja e punës lidhur me lektorim dhe përkthim; 4.3 Mbikëqyrja e punëve lidhur me mirëmbajtjen e objektit të komunës	Gjatë tërë vitit	Udhëheqësi Sektorit	

5. Ofrimi i shërbimeve të përkthimit	5.1 Përkthim në mbledhjet e organizuara nga kryetari, Kuvendi i komunës si dhe mbledhje, takime, etj, 5.2 Përkthimi i të gjitha dokumenteve sipas kërkesave të zyrtarëve të administratës komunale.	Gjatë tërë vitit	Përkthyesi	
7. Ofrimi i shërbimeve të lekturës	7.1 Lektorimi i dokumenteve të kuvendit, kryetarit dhe dokumenteve të shërbimeve tjera sipas kërkesave të zyrtarëve të administratës komunale; 7.2 Asistim në përpilimin e terminologjisë së unifikuar ligjore dhe arsimore 7.3 Mbështetje stafit lidhur me shkresat në përmbajtjen e tyre në aspektin e strukturës sintaksore (gjuhësore)	Gjatë tërë vitit	Lektori	
8. Pranimi i mallrave, punëve dhe shërbimeve	8.1 Inspektimi, testimi dhe nënshkrimi i pranimit të materialeve, punëve dhe shërbimeve; 8.2 Parashtron kërkesë te Drejtori i drejtorisë ose Menaxheri i Prokurimit në rast nevojë për formimin e komisioneve për pranim; 8.3 Mban evidence për pranimin e mallit dhe i proceson të dhënat në sistem; 8.4 Mban shënime mbi dërgesat e mallit si dhe shpërndarjen e tij 8.5 Bënë dorëzimin e dokumentacionit me protokoll në drejtim të zyrtarit të pasurisë me qëllim të regjistrimit të pasurisë	Gjatë tërë vitit	Zyrtari i pranimit	
9. Mirëmbajtja e të gjitha stabilimenteve elektrike dhe teknike në lokalet e ndërtesës së komunës si dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit në objektin e komunës, pastërtisë dhe nyjave sanitare.	9.1 Ndërrimi dhe riparimi i stabilimenteve, montimin e pjesëve të reja sipas nevojës së parashtruar; 9.2 Kujdesi për funksionalitetin e sistemit të ngrohjes/ftohjes; 9.3 Mirëmbajtja e inventarit nëpër zyra; 9.4 Kujdesi për funksionalitetin e gjeneratorit dhe ashensorit; 9.5 Kujdesi për furnizimin me mjete higjienike për nevoja të objektit të komunës;	Gjatë tërë vitit	Operatori teknik-Mirëmbajtësi	

Qendra e Shërbimit për Qytetar

Qëllimi kryesor (Objektivat)	Aktiviteti (Detyrat)	Afatet	Bartësit	Vërejtje
------------------------------	----------------------	--------	----------	----------

Pranimi i te gjitha kërkesave/ankesave të parashtruara nga qytetarët/bizneset dhe grupet e interesit	1.1. Pranimi dhe regjistrimi i lëndëve në sistem, 1.2. Pranimi dhe skanimi i të gjitha lëndëve të parashtruara nga palët drejtuar institucionit të Komunës, 1.3. Informimi i duhur mbi procedurat që duhet të ndjekin palët me rastin e paraqitjes së kërkesës, 1.4. Dhënia e ndihmës palës me rastin e paraqitjes së kërkesës, 1.5. Njoftimi i palëve përmes telefonit mbi ecurinë e lëndës (për marrjen e vendimit apo plotësimin e lëndës).	Gjatë gjithë vitit	Zyrtarë të QSHQ-së	
2. Përdorimi dhe respektimi i Akteve ligjore dhe nënligjore në mënyrë të drejte dhe të sakte	2.1. Përdorimi dhe zbatimi i ligjit për procedurën e përgjithshme administrative nr.05/L-031, 2.2. Përdorimi dhe zbatimi i udhëzimit administrativ për QSHQ-te 2011/03, 2.3. Zbatimi i rregulloreve të brendshme komunale.	Gjatë gjithë vitit	Zyrtarë të QSHQ-së	
3. Përcjellja e kërkesave /lëndëve tek drejtoritë përkatëse përmes sistemit dhe përmes dorëzimit fizik, gjatë vitit 2023 do të përpiqemi që dorëzimi fizik të eliminohet, do të përdoret vetëm në raste kur është e domosdoshme	3.1. Regjistrimi i lëndëve në librat e protokollit sipas Drejtorive/zyrave përkatëse, 3.2. Dorëzimi i lëndëve tek drejtorit/zyrat përkatëse, 3.3. Pranimi i postës dhe shpërndarja e saj tek zyrtarët përgjigjes, 3.4. Shpërndarja e materialit zyrtar tek zyrtarët përgjigjes, 3.5. Dërgimi i shkresave tek palët përmes postës dhe personalisht sipas nevojës.	Gjatë gjithë vitit	Receptionisti (derguesi i postes) i QSHQ-se	Prej janarit deri në qershor do të përpiqemi që dorëzimi i fizik i lëndëve të eliminohet (vetëm në raste kur është e nevojshme)
4. Protokollimi i të gjitha dokumenteve komunale me një protokoll unik të gjeneruar nga sistemi i softuerit.	4.1. Protokollimi i të gjitha dokumenteve komunale me numër protokollit nga sistemi i softuerit, 4.2. Skanimi i të gjitha dokumenteve të protokolluara	Gjatë gjithë vitit	QSHQ-se	

Zyra për të drejtat e njeriut

<i>Nr .</i>	<i>Qëllimi kryesor (Objektivat)</i>	<i>Aktiviteti(Detyrat)</i>	<i>Afati</i>	<i>Bartës</i>	<i>Buxheti</i>
1.	Mbrojtja e të drejtave të	- Vizita nëpër të gjitha	Janar -	Zyrtarja për	

	njeriut dhe barazia gjinore dhe mos diskriminim	<p>institucionet publike dhe private më qëllim të verifikimit: a janë të mbrojtura të dy gjinitë sipas ligjit, a kanë kontrata a marrin rrogë njësoj, për punën e njëjte. Sa respektohet pushimi i lehonisë i garantuar me ligjin në fuqi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hulumtim i shkaqeve të braktisjes së shkollës nga nxënësit - Vetëdijesimi në zonat rurale për të drejtat trashëgimorë te grave 	Dhjetor	Barazi Gjinore, zyra e personelit, Punëdhënësit Qendra për punësim dhe aftësim	
2.	Avancimi i pozitës shoqërore se femrës në vendimmarrje.	<ul style="list-style-type: none"> - Organizimi fushatave vetëdijes se kundër trafikimit më qenie njerëzore . - Ofrimi i trajnimeve profesionale për gratë me fokus të veçantë për gratë e nivelit të ulët të shkollimit dhe atyre të kanë qen ngjatë pa punë - Ofrimi i trajnimeve profesionale për gratë 	Punë kontinuele gjatë vitit vijues	Zyrtarja për Barazi Gjinore	
3.	Inkurajimi i femrave në punësim dhe femrave që do të duhej të promovohen dhe personave me nevoja të veçanta.	<ul style="list-style-type: none"> - Avokimi për njohjen dhe rishpërndarjen e punës së papaguar të grave; - Mbështetja e ndërmarrësisë së grave nëpërmjet trajnimit të aftësive dhe teknikave të prodhimit. - Mbështetja e përpjekjeve për të forcuar të drejtat ligjore të grave të prone - Aktivitete informuese për promovimin e të drejtës për pushimin e lehonisë - Inkurajimi i femrave vetëshqyese në punësim 	Punë permanent e për gjatë gjithë vitit.	Zyrtarja për Barazi Gjinore Komuna Enti për punësim Qendra për punë sociale	

		dhe femrave që do të duhej të promovohen dhe personave me aftësi të kufizuar.			
4.	Përgatitja e një data baze, statistikore për buxhetimin gjinore në Komunën e Vushtrrisë duke përfshirë punësimin mbrojtjen shëndetësore, pjesëmarrjen në politikë dhe pozita vendimmarrëse	<ul style="list-style-type: none"> - Vizita nëpër të gjitha institucionet publike dhe private më qëllim të verifikimit: a janë të mbrojtura të dy gjinitë sipas ligjit, a kanë kontrata a marrin rrogë njësoj, për punën e njëjte. Sa respektohet pushimi i lehonisë i garantuar me ligjin në fuqi 	Janar-Dhjetor	Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut dhe mbrojtjen e fëmijëve, zyra e personelit, Punëdhënësit Qendra për punësim dhe aftësim	
5.	Vetëdijesimi në zonat rurale për të drejtat trashëgimorë	<ul style="list-style-type: none"> - Hulumtim i shkaqeve të braktisjes së shkollës nga nxënësit në komunën e Vushtrrisë, verifikimi i rasteve të nxënësve shkollimi i të cilëve varet nga pagesa e një bilete autobusi - Inicim i Seancave pa pagës me Psikologun për nxënës që e braktisin shkollën, ose që kanë potencial për ta braktisur - Vizita në shkolla të komunës, ligjërata dhe aktivitete të ndryshme 	Zyrtarja për Barazi Gjinore , Drejtorja e Arsimit , Drejtoret e shkollave Drejtorja për Mirëqenie Sociale Enti për Pune Psikologu i Shkollës NJKDNJ, ZBGJ	Ka filluar procesi, është në vazhdimësi	
6.	Inkurajimi i femrave në punësim dhe femrave që do të duhej të promovohen dhe personave me nevoja të veçanta.	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e raporteve statistikore të pjesëmarrjes së femrave, gjithashtu edhe raporti mbi kualifikimin e tyre. - Organizimi i debateve, seminare trajnime. - Avokimi për njohjen dhe rishpërndarjen e punës së papaguar të grave; - Mbështetja e ndërmarrësisë së grave nëpërmjet trajnimit të aftësive dhe teknikave të prodhimit. - Mbështetja e përpjekjeve për të forcuar të drejtat 	Zyrtarja për Barazi Gjinore Komuna Enti për punësim Qendra për punë sociale	Punë permanente për gjatë gjithë vitit.	

		ligjore të grave të prone			
7.	Subvencionimi i pagesës për kopshtet e fëmijëve të nënave vetë-ushqyese, përfituese të skemave sociale	-	Drejtoria për Mirëqenie Sociale Enti për Punë Psikologu i Shkollës	Permanent	
8.	Fuqizimi i Bashkëpunimit mes Zyrtares për Barazi Gjinore dhe OJQ të grave të komuniteteve përmes aktiviteteve të përbashkëta	- Organizimi i 4 takimeve gjate vitit me temë "Përkrahja dhe bashkëpunimi i OJQ-ve të grave të komunitetit serb, turk, rom, ashkali etj në 4 tema specifike" aspektet dhe bashkëpunimi i me ngushtë me OJQ.	Punë Kontinuel e gjatë vitit	Zyrtarja për Çështje Gjinore. ZKK OJQ-ve	2.400,00
9.	Organizimi fushatave vetëdijesuese kundër trafikimit më qenie njerëzore .	- 4 fushatave vetëdijesimi për parandalimin e trafikut më qenie njerëzore - Identifikimi i numrit të personave të trafikuar - Identifikimi Nevojave të tyre primare - Adresimi i këtyre kërkesave Institucioneve përgjegjëse	Maj – Nëntor <i>Ne bashkëpunim me OJQ dhe KVL</i>	Policia e Kosovës Zyrtarja për Barazi gjinore, Zyrtarja për Mbrojtjen e Fëmijës, QPS Gjykata	2.000,00
10	Shënimi i ditëve të rëndësishme	4 Shkurt Dita Ndërkombëtare kundër kancerit Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të gruas, 8 Marsit	Datat e përcaktuara	Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	1000
		21 Marsi Dita ndërkombëtare e luftës kundër Diskriminimit Racor		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	100 200
		21 Mars, Dita ndërkombëtare e personave me sindromë Down			
		8 Prill Dita Ndërkombëtare e Romëve		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	100
		9 Prilli Dita Ndërkombëtare e Kushtetutës		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		1 Qershori Dita Ndërkombëtare e fëmijëve		Zyrtarja për Barazi Gjinore/Zyrtarja	

				për të Drejtat e Njeriut	
		12 Qershor- Dita Ndërkombëtare kundër shfrytëzimit të punëve të rënda të fëmijëve		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut dhe mbrojtjen e fëmijëve.	
		23 Qershor Dita Ndërkombëtare e shërbyesve Civil		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut dhe mbrojtjen e fëmijëve.	
		12 Gusht Dita Botërore e rinisë		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut dhe mbrojtjen e fëmijëve.	
		27 Gusht Dita ndërkombëtare e të zhdukurve		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		2 Shtator Dita botërore e trashëgimisë		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		15 Shtator Dita Ndërkombëtare e Demokracisë		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		21 Shtator, Dita Ndërkombëtare e paqes		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		1 Tetor Dita Ndërkombëtare e personave të moshuar		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		10 Tetor Dita Botërore e shëndetit mendo		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		11 Tetor Dita Botërore e çikave		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	

		15 Tetor Dita e Shkopit të bardhe		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		16 Tetor Dita e mundësive të barabarta		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		18 Tetor, Dita Ndërkombëtare Kundër Trafikim		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		19 Nëntori Dita ndërkombëtare për parandalimin e abuzimit të fëmijëve		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		20 Nëntor Përvjetori i konventës ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		25 Nëntori Dita ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		1 Dhjetori Dita botërore e luftës kundër HIV/AIDS		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		5 Dhjetor Dita ndërkombëtare e vullnetareve		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		10 Dhjetor Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut		Zyrtarja për Barazi Gjinore/Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		20 Dhjetor Dita Botërore e Solidaritetit Njerëzor		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
11.	Fuqizimi i Bashkëpunimit mes Komunës dhe OJQ përmes aktiviteteve të përbashkëta	Organizimi i 4 takimeve gjatë vitit me temë "Përkrahja dhe bashkëpunimi i OJQ-ve të grave të komunitetit serb, turk, rom, ashkali etj në 4 tema specifike" aspektet dhe bashkëpunimi i me ngushtë me OJQ.	Gjatë gjithë vitit	Zyrtarja për Çështje Gjinore. ZKK OJQ-ve	

Arsimi

QËLLIMI

Sistemi arsimor para universitar të zhvillojë kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; përmes realizimit cilësor të kompetencave të jenë të gatshëm të krijojnë zhvillim të qëndrueshëm.

VIZIONI

Arsim cilësor, gjithëpërfshirës që siguron progres në zhvillimin ekonomik të vendit duke krijuar kushte të përshtatshme për të zhvilluar mësim nxënie dhe mësimdhënie bashkëkohore.

PLANI VJETOR

Drejtoria Komunale e Arsimit në funksion të përgjegjësisë organike të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe strategjinë e zhvillimit ekonomik të komunës ka hartuar planin e punës për vitin 2024 . Duke ndjekur objektivat e hartuara me koordinim me politikat e MASHTI, interesat kombëtare dhe shtetërore si dhe në Planin Zhvillimor Komunal të Arsimit. Prioritetet kryesore në të cilat mbështet plani i punës i DKA-së, janë:

- *Mjedis shkollor i përshtatshëm për mësimdhënie dhe mësim nxënie efektive;*
- *Organizimi dhe mbajta e garave të ndryshme;*
- *Mbikëqyrje dhe monitorim i vazhdueshëm në të gjitha institucionet e nivelit parauniversitare, lidhur me përkrahjen dhe rritjen e përgjegjësisë;*
- *Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë dhe zbatimi i KK-së;*
- *Bashkëpunimi dhe ndërveprimi me të gjithë palët në interes të zhvillimit të arsimit;*

PASQYRA E PLANIT VJETOR TË PUNËS PËR VITIN 2024

Objektiva 1. Mjedis shkollor i përshtatshëm për mësimdhënie dhe mësim nxënie efektive

Nr.	Aktivitetet	Financuar ne euro	Afati zbatimit	Bartësit e aktiviteve	Ndërlidhja me aktet tjera
1	Rehabilitimi i oborrit të shkollës në SHMU-2 Vushtrri	30,000.00 €	Qershor - Tetor	<ul style="list-style-type: none">• DKA• Drejtoria e prokurimit• Drejtoria për Buxhet dhe Financa	PZHKA

